

VENDIM
Nr.567, datë 12.8.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2003, NË PROJEKTIN “FURNIZIMI
ME ENERGJI ELEKTRIKE NË SHQIPËRINË E JUGUT - BISTRICA II-FINANCIM
I PËRZIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2003, në projektin “Furnizimi me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut - Bistrica II - Financim i përzier”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2003
“FURNIZIMI I SHQIPËRISË JUGORE ME ENERGJI ELEKTRIKE — BISTRICË II —
FINANCIM I PËRZIER”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 25 nëntor 2003 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Palët Kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua me vlefë prej gjithsej deri 1 500 000 euro (me fjalë: një milion e pesëqind mijë euro) për projektin “Furnizimi i Shqipërisë Jugore me energji elektrike — Bistricë II — Financim i përzier”. U konstatua se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e

varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin I ose shuma financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1) Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftehet në rast se kontrata përkatëse për hua nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2011.

2) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 20.7.2005 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjerman, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.